



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**  
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. 2020

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

**2 (dy) Specialist Mjek/Ekonomist në Sektorin e Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Spitalor, pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë.**

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbush kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi Civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë diplomë në fushën e Mjekësisë/Ekonomisë;
- Të jetë i komunikueshëm dhe të ketë aftësi të punës në grup;
- Të zotërojë kompjuterin;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja do të jetë avantazh ( preferohet anglisht);
- Nota mesatare do të jetë avantazh;

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë, **brenda datës 29.05.2020**, këto dokumenta;

- Kërkesë për punësim;
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale ( Curriculum Vitae);
- Diplomë e noterizuar;
- Diplome master e noterizuar;
- Listë notash e noterizuar;
- Çertifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;

- Librezën e punës;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Dëshmi penaliteti (të datojë brenda 3 muajëve të fundit);
- Raport mjekësor për aftësi në punë;

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë .

**Adresa: Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Korçë . Rruga: “1 Maj”, Lagjia 9 Tel. +35582242706. E - mail:korçë@fsdksh.com.al  
Web://www.fsdksh.com.al**